

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-24-8456-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me filtra dhe elemente seperuese; Lot 1-Furnizim me filter vaji per valvat rregulluese ne turbine; Lot 2-Furnizim me filter ajri dhe elemente seperuese te kompresorit C6**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Segment Kosova SH.P.K.
NUI	810871328
Adresa	Lagja Marigona, Preoc, Gracanice
Vendi	Gracanice
Kodi postar	10500
Numri Telefonit	038/733794
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ilir Zhabari
Adresa elektronike	procurement@segment-rks.com
Data e parashtrimit të ankesës	13.02.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 2-Furnizim me filter ajri dhe elemente seperuese te kompresorit C6

22.01.2025 - AK përmes Njoftimit mbi Vendimin e AK-së njofton pjesëmarrësit e aktivitetit të prokurimit se anulohet aktiviteti i prokurimit, ndërsa oferta e OE Segment Kosova është dashur të refuzohet pasi që personi i autorizuar i kompanisë nuk është i autorizuar të përfaqësoj kompaninë në aktivitetet e prokurimit në ndëmmarrjet publike.

27.01.2025 - OE Segment paraqet Kërkesën për Rishqyrtim.

03.02.2025 - OE Segment pranon Vendimin e AK-së, i cili refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të OE Segment lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

13.02.2025 - OE Segment paraqet këtë Ankesë pranë OSHP per Lot 2-Furnizim me filter ajri dhe elemente seperuese te kompresorit C6.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

Kërkesa jone per rishqyrtim eshte refuzuar, po e bashkangjesim vendimin e AK lidhur me Kërkesen per Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK bën shkelje të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përkatësisht të këtyre dispozitave:

- * **Neni 59**, paragrafi 4 mbi ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

- * **Neni 60** mbi kriteret për dhënien e kontratës i cili përcakton se kur një ofertues i përgjegjshëm shpërblehet me kontratë.

- * **Neni 62** mbi përfundimin e aktivitetit të prokurimit i cili shprehimisht përcakton shkaqet për arsyet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në arsyetimin për eliminim, Autoriteti Kontraktues arsyetohet se aktiviteti i prokurimit anulohet bazuar në nenin 62, ndërsa OE Segment Kosova është shpallur i eliminuar për "LOT 2 Furnizim me filter ajri dhe elemente seperuese te kompresorit C6" për arsye se personi i autorizuar Egzon Zeqiri nuk është i autorizuar të përfaqësoj kompaninë në aktivitetet e Prokurimit në ndërmarrjet publike, prandaj, oferta duhet të refuzohet.

Me Kërkesën për Rishqyrtim, OE Segment Kosova ka dëshmuar se Z. Egzon Zeqiri është i pajisur me autorizim të përgjithshëm noterial dhe është person i autorizuar për të përfaqësuar OE Segment Kosova në të gjitha aktivitetet e prokurimit duke përfshirë

ofertimin dhe nënshkrimin e kontratave publike.

Në arsyetimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues arsyetohet se autorizimi i Z. Egzon Zeqiri nuk është i lëshuar për ndërmarrje publike, dhe meqë KEK është kompani publike, konsideron se autorizimi nuk është i vlefshëm dhe oferta e OE Segment Kosova është refuzuar mbi këtë bazë.

Ndërsa për të justifikuar anulimin e aktivitetit të prokurimit, e cila nuk ka fare bazë sipas nenit 62 të LPP-së, AK shton arsyetimin se oferta e OE Segment Kosova kishte çmim shumë më të lartë se ofertat e tjera të pranuar, kështu AK vendimin për anulim e ka marrë duke pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, e i cili arsyetim nuk ishte dhënë në letrën standarde të eliminimit.

Mirëpo, oferta e OE Segment Kosova është oferta e vetme e përgjegjshme, me çmim të tregut dhe me çmim brenda buxhetit të alokuar nga AK për këtë aktivitet të prokurimit.

1. Pretendimi ankimor nr. 1: Egzon Zeqiri është i pajisur me të gjitha autorizimet për përfaqësim të OE Segment Kosova në aktivitete të prokurimit

AK në Vendim për kërkesë për rishqyrtim se autorizimi i bashkëngjitur me ofertën e OE Segment Kosova nuk është i lëshuar për ndërmarrje publike siç është KEK. Mirëpo, ky arsyetim nuk qëndron fare për arsyet si më poshtë.

Z. Egzon Zeqiri është i punësuar në OE Segment Kosova dhe një kohë të gjatë është person i autorizuar nga OE Segment Kosova që të përfaqësoj kompaninë në kuadër të aktiviteteve të saj.

Janë disa arsye të veçata në lidhje me këtë:

- a) Egzon Zeqiri i është lëshuar Autorizim Gjeneral Noterial, të nënshkruar pranë Noterit Fatmir Tasholli, datë 16.12.2021 me LRP.nr.9799/2021, dhe ka të gjitha autorizimet për të përfaqësuar OE Segment Kosova në aktivitete të prokurimit, duke përfshirë ofertat dhe nënshkrimin e kontratave.
- b) OE Segment Kosova ka aplikuar në aktivitete të ndryshme të prokurimit dhe është shpërblyer me Kontratë, duke përfshirë vetë AK KEK, përmes Z. Egon Zeqiri, dhe në të gjitha rastet autorizimet e tij janë vlerësuar të vlefshme.
- c) Edhe sikur të mos ekzistonte autorizimi noterial, Z. Egzon Zeqiri i ka të gjitha autorizimet e tilla për të aplikuar në tenderë publik dhe nënshkruar Kontrata në përputhje me organogramin dhe pozitën e tij të punës në OE Segment Kosova.

a) Autorizim për Z. Egzon Zeqiri është i formalizuar ashtu që, OE Segment Kosova, me datë 16.12.2021, pranë noterit Fatmir Tasholli, i ka dhënë Z. Egzon Zeqiri autorizim gjeneral që në interesin material dhe juridik të biznesit, të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura juridike dhe atë:

- 1) para organeve administrative publike; dhe
- 2) pranë OSHP-së, në të gjitha Zyrat e Prokurimit pranë cilës do Komunë, duke nënshkruar të gjitha marrëveshjet dhe kontratat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e biznesit dhe të ushtroj të gjitha mjetet e rregullta juridike dhe jashtëzakonshme juridike.

Vet fakti se ky autorizim është gjeneral nënkupton se Z. Egzon Zeqiri është person i autorizuar për OE Segment Kosova gjatë tërë veprimtarisë së OE Segment Kosova dhe mund të ndërmarrë veprime në emër të OE Segment Kosova të cilat lidhin ligjërisht këtë të fundit sikurse të ishin marrë nga vet ai.

Ky autorizim është dhënë për kohë të pacaktuar dhe është në fuqi deri në revokimin e të njejtit nga dhënësi i autorizimit, gjë që deri më tani nuk ka ndodhur.

b) Në të gjitha tenderët në të cilët ka aplikuar OE Segment Kosova, duke përfshirë edhe vetë KEK, të gjitha aplikimet dhe nënshkrimet e bëra janë nga Z. Egzon Zeqiri. Rrjedhimisht, është tërësisht i kundërligjshëm dhe tendencioz ky qëndrim në këtë fazë të eliminohet OE Segment Kosova si i papërgjegjshëm. OE Segment Kosova ka aplikuar në dhjetra aktivitete të prokurimit dhe ka lidhur kontrata për panumrueshme me ndërmarrje publike përmes të autorizuarit Z. Egzon Zeqiri, dhe në asnjë rast nuk është kontestuar autorizimi i tij për të përfaqësuar OE Segment Kosova në çështje të prokurimit publik.

c) Edhe në situatën hipotetike sikur të mos ekzistonte autorizim noterial, Z. Egzon Zeqiri i ka të gjitha autorizimet e tilla për të aplikuar në tenderë publik dhe nënshkruar Kontrata në përputhje me organogramin dhe pozitën e tij të punës në OE Segment Kosova.

Andaj, Z. Egzon Zeqiri është person i autorizuar nga OE Segment Kosova të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në emër dhe për llogari të OE Segment Kosova, duke përfshirë këtu aplikimin në aktivitete të prokurimit si dhe nënshkrimin e çfarëdo marrëveshje apo kontrate me ndërmarrje të ndryshme publike.

Rrjedhimisht, pretendimi i AK se OE Segment Kosova është i papërgjegjshëm kur qartë shihet se Z. Egzon Zeqiri është i pajisur me autorizim, përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe se i njëjti duhet të shpërblehet me kontratë.

1.
2. **2.Pretendimi ankimor nr. 2: Nuk Janë Paraqitur Asnjë nga Shkaqet e Përcaktuara në Nenin 62 të LPP-së Për Çka Aktiviteti i Prokurimit Mund të Anulohet**

Neni 62 i LPP-së përcakton arsyet e përfundimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht anulimin, atëherë kur aktiviteti i prokurimit nuk do të rezultoj në dhënien e kontratës. Ky nen në mënyrë specifike identifikon shkaqet e anulimit. Përkatësisht, ndër të tjera, se një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Asnjëra nga këto arsye nuk është paraqitur nga AK.

Në këtë drejtim, për shkak se oferta e OE Segment Kosova është tërësisht e përgjegjshme sipas edhe sqarimeve të përshkruara në Pretendimin Ankimor nr.1, anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk mund të qëndroj, por OE Segment Kosova duhet shpërblyer me kontratë.

Në fakt, neni 97 i Rregullores për Prokurim Publik përcakton shprehimisht se çka konsiderohet si shkelje e rëndë nga ana e AK-së. Përkatësisht, pika k. e këtij neni parasheh shkelje të rëndë të AK-së atëherë kur e njëjta anulon një aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Kjo nënkupton dhe përforcon argumentin se duhet shfaqur medoemos shkaqet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së në mënyrë që anulimi i aktivitetit të prokurimit të jetë i ligjshëm.

Në rastin e aktivitetit të prokurimit në fjalë, shihet qartë se asnjë nga shkaqet e nenin 62 nuk janë paraqitur ashtu që AK të mund të anuloj aktivitetin e prokurimit.

Për më tepër, AK mundohet të arsyetoj anulimin e aktivitetit të prokurimit duke konstatuar se çmimi i ofertës së OE Segment Kosova është më i lartë se ofertat e tjera edhe pse këtë arsyetim nuk e kishte dhënë në letrën standarde të eliminimit. Mirëpo, në përputhje me nenin 60, paragrafin 1, pikën 1.1 të LPP-së, kriteri për dhënien e kontratës është **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**.

Edhe po që se çmimi ofertues i OE Segment Kosova është më i lartë, LPP detyron AK-në që të shpërblej me kontratë tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët në mesin e ofertave të përgjegjshme. Ofertat e tjera për këtë aktivitet të prokurimit nuk kanë qenë të përgjegjshme dhe janë eliminuar për arsye të ndryshme. Në anën tjetër oferta e OE Segment Kosova është eliminuar pa bazë dhe si e tillë është tërësisht e përgjegjshme. Prandaj, pavarësisht faktit se çmimi ofertues i OE Segment Kosova është më i lartë se

ofertat e tjera, e njejta duhet të shpërblehet me kontratë, pasi që në mesin e ofertave të përgjegjshme, ku figuron vetëm OE Segment, çmimi ofertes është çmimi më i lirë dhe brenda buxhetit të alokuar nga AK për këtë aktivitet të prokurimit.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 62 të LPP-së dhe nenit 97 të Rregullores për Prokurim publik, anulimi i aktivitetit të prokurimit në fjalë është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet të përmirësohet.

KËRKESA:

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme, ftohet Organi Shqyrtues i Prokurimit që të nxjerr Vendim ashtu që:

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e OE Segment Kosova me nr. të prokurimit KEK-24-8456-1-2-1, me Titull: "Furnizim me filtra dhe elemente seperuese; Lot 2 - Furnizim me filter ajri dhe elemente seperuese te kompresorit C6".
- II. ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontaktues, për anulimin e procedurës lidhur me Aktivitetin e Prokurimit KEK-24-8456-1-2-1.
- III. NJOFTOHET** OE Segment Kosova për dhënie të Kontratës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik SEGMENT KOSOVA SH.P.K. është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.